



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 796 Akti

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M

Nr.223, Datë 30.12.2020

Për miratimin e raportit përfundimtar dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 129, datë 22.10.2020 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në këtë institucion.

Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit është institucion në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, veprimtaria e të cilit përcaktohet dhe rregullohet me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin të gjitha institutet e ligjit për nëpunësin civil, ndër të cilat, evidentimin e pozicioneve që kryejnë funksione të shërbimit civil; deklarinim

e statusit të punësimit për çdo punonjës të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; respektimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil; hartimin e formularit të përshkrimit të punës; miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil; rekrutimet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm; pezullimin nga shërbimi civil; realizimin e vlerësimeve të punës për nëpunësit civil; kryerjen e trajnimeve të detyrueshme për nëpunësit civil në periudhë prove, etj.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 796/1, datë 22.10.2020, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 193/2, datë 13.02.2020 “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit”, i është njoftuar subjektit të mbikëqyrjes.

Pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën nr. 1057/2 prot., datë 07.12.2020 “Dërgohet projektraporti” (protokolluar në KMSHC me nr. 796/8 prot., datë 14.12.2020), institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Komisioneri çmon se, gjatë procesit të mbikëqyrjes, ashtu si është materializuar situata edhe në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, nga ana e grupit të punës nuk janë konstatuar parregullsi ligjore gjatë veprimeve administrative të kryera nga subjektet e ngarkuara prej ligjit me administrimin e shërbimit civil, të natyrës që të kërkojnë ndërhyrjen e këtij institucioni për të rregulluar paligjshmërinë, e për këtë arsye, vlerësoj se në këtë rast nuk është i nevojshëm një vendim paralajmërues.

Nga ana tjetër, duhet të tërheq vëmëndjen e të gjithë aktorëve të ngarkuar me administrimin e procesit të vlerësimit të rezultateve të punës, pasi i kanë vlerësuar në të njëjtën mënyrë të gjithë nëpunësit civilë të institucionit, me nivelin maksimal të vlerësimit, I “shumë mirë”.

Në këtë rast, edhe pse nuk ndodhemi përpara shkeljeve të natyrës procedurale, nga pikpamja materiale e procesit mund të evidentohen si parregullsi, në kushtet kur nuk është përdorur i gjithë spektri i vlerësimeve, në katër nivele, duke të krijuar përshtypjen e një procesi subjektiv vlerësimi, por që në këtë rast nuk janë të asaj natyre që të sjellin pavlefshmëri të procesit të

vlerësimit, pasi nuk e cënojnë në thelb atë. Kjo parregullsi është evidentuar me qëllim që të mbahet parasysh dhe të rregullohet në të ardhmen.

Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil, synon të përmirësojë aftësitë profesionale të nëpunësve, si dhe të ndikojë në cilësinë e shërbimit të ofruar prej tyre, e për këtë arsye, zyrtarët e përfshirë në këtë proces (*Zyrtari raportues/Zyrtari kundërfirmues/Zyrtari autorizues*), duhet të jenë sa më objektivë gjatë kryerjes së kësaj procedure.

Detyrë e njësisë përgjegjëse në këtë rast, mbetet që të orientojë procesin dhe menaxherët e tij, për të sjellë sistemin e vlerësimit të punës, sa më afër objektivitetit dhe realitetit, duke përdorur të gjithë spektrin e vlerësimeve që përcaktohet në ligj dhe aktin nënligjor, si dhe duke e materializuar procesin në dosje personale për çdo nëpunës të vlerësuar, ku të jenë të pasqyruara të gjitha veprimet administrative që kanë lidhje me të gjitha fazat e vlerësimit, që janë planifikimi, bisedimet e ndërmjetme dhe vlerësimi përfundimtar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes pa vendim paralajmërimi, pasi nuk janë konstatuar parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, referuar Seksionit III "*Procedura hetimore*", të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", si dhe nenit 34, të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion, pasi nuk u konstatuan parregullsi gjatë zbatimit të ligjit për shërbimin civil.

2. Për këtë vendim të njoftohet Drejtori i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha